

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 dhe nenit 15 paragrafi 8 dhe 9 të Ligjit nr.08/L-332 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.22/2014), nenit 12 paragrafi 2 pika d) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.28/2008) dhe nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e tretë të rregullt, e mbajtur më datën 24.03.2025, merr këtë:

V E N D I M NR.12/2025/KG

për transferin e miratuar të personelit dhe transferin e shumës përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe shtesa në paga”

Neni 1

Miratohet vendimi për transferin e miratuar të personelit për pozitën Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale (Drejtor i Qendrës për Punë Sociale) dhe transferin e shumës përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe shtesa në paga” në vlerë prej 7.500 euro.

Neni 2

Transferi i mjeteve buxhetore dhe numri i të punësuarve për një (1) transferohen në kuadër të Komunës së Graçanicës me kod 618, nga kodi i programit 660, nën-programi “Planifikimi urban dhe inspeksioni” me kod 66345, nga kategoria e shpenzimeve “Paga dhe shtesa në paga” dhe transferohen në programin 755, nën-programin “Shërbimet sociale-Graçanicë” me kod 75536 në kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe shtesa në paga” si dhe transferi i numrit prej një (1) të punësuarve në këtë nën-program.

Neni 3

Detyrohet drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që t’i ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe ta përgatisë propozimin me shpjegim, për miratim nga ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Neni 4


Për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjëse Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr.228/25 (nr. 04/2025/KG) i datës 29.01.2025 për ndryshimet e miratuara në personel dhe shumës përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve “paga dhe shtesa në paga”.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević